

Valentina Pajaziti, MA¹

UDC:
7.038.55:391.3
391.3:7.05]:7.038.55

**POSTMODERNIZMI DHE SIMBIOZA E MODËS DHE
DIZAJNIT NË INSTALACIONE**

**ПОСТМОДЕРНИЗМОТ И СИМБИОЗАТА НА МОДАТА И
ДИЗАЈНОТ ВО ИНСТАЛАЦИИ**

**POSTMODERNISM AND THE SIMBIOUS OF MODE AND
DESIGN IN INSTALLATIONS**

Abstract

Changing tastes varies over time, so the way of doing art has changed and continues to change, from techniques and materials. Art today is so different and so great that methods are many in the realization of an artistic work, no matter which art genre belongs. The language of art today speaks through material, fluorescent lights, letters, textiles, garbage, photographs, traditional colors, video games, and so on. The ancient art links (ties) and modern artist's skills bring shape to the most diverse of conceptual art. The purpose of modern art is the purpose of new ideas show by turning them into fabricated materials or using materials in the language of communication with the public. In the continuation of modern life, many artists ask to create and invent

¹ Ph.D candidate, Universiteti i Tetovës, Fakulteti Filozofik, Programi studimor: Pedagogji, Tetovë, Republika e Maqedonisë, pajazitivalentina@hotmail.com

their worlds through the imagination of realizing of the ideas. Postmodernism that supports experimental laboratory research opens up new perspectives in the fields of art, science and technology. The purpose that is distinguished in modernity is the concept and the connection to art. Women's dress (clothing) that has reform are the promotion of their emotional and social status. The woman's dress is a symbol of beauty, a symbol of pain, suffering, symbol of love, a symbol of protection and revenge. Exploring of the material with the potential of women are two related fields, showing evidently the influence of force and instinct.

Keywords: art, clothing, material, woman, corsets.

HYRJE

Në vazhdimin e jetës moderne shumë artistë kërkojnë të krijojnë dhe të shpikin botën e tyre përbrenda imagjinatës në realizimin e ideve. Përmes ideve tona konkrete paraqesim botën e brendshme artistike dhe atë të jashtme shoqërore, duke paraqitur realitetin në kohë reale. Kështu që, idetë të artistët lindin prej një intuete të zhvilluar për të krijuar një vepër arti me rëndësi jetike, e cila shpeshherë ruhet në sekretet e tij shpirtërore, e më pas, përmes muzës apo frymëzimit paraqitet në një vepër arti real, ku pastaj ajo vepër arti kthehet një shije e veçantë për një komunitet. Njohja me teknologjinë dhe shkencën, artistit i ofrohen mundësi të depërtojë në realizimin e eksperimenteve artistike. Bota moderne që ka për qëllim teoritë e reja për art dhe jetë praktike ajo sot po përhapet me një shpejtësi të madhe si në teknologji po ashtu edhe në ide novatore.

Postmodernizmi që mbështet kërkimet laboratorëske eksperimentale hap perspektiva të reja në fusha të artit, shkencës dhe teknologjisë. Qëllimi që shquhet në modernizëm është koncepti dhe lidhja që i bëhet artit. Disa stilistë (artist) propozojnë publikut veshje të përziera me teknologjinë, dhe kjo vjen në një kohë kur para modës shtrohen ide jo më të ndjekjes, por të gjetjes së ideve të reja dhe në funksion të çdo individi që mund t'i shërbejë dhe në praktikë.

E thënë ndryshe nuk ka më as një rregull në lojën e modës. Ashtu si në art edhe moda filloi të degëzohej. *Hussein Chalayan, në vitin 1994 ekspozoi korsetin e tij, nga druri i ngjeshur për trupi duke shtrënguar me vida te metalit.*²

² The Collection of the Kyoto Costume Institute, "Fashion", A History from the 18th to 20th Century, Taschen, Bibliotheca Universalis, 1995, f.604.

Në rrugëtimin e zhvillimit të njeriut gjithmonë kemi shfaqur interes për trupin apo format, si dhe kemi ndikuar duke garantuar në plotësimin e nevojave të tyre. Në këtë rast, fletë materiali i përzgjedhur i cili ka aftësinë e forcës dhe mendjes që femra di të modelojë me delikatesë konturet ideale të saj dhe na mbërthen në boshtin e ngrohtë. Joshjet e mundshme të femrës, synimi dhe pikëpamjet e ndryshme të gjendjes së saj në shoqërinë që e rrethon, e që vazhdimisht theksohet me veshjen, duke futur arsyen përpara realitetit. Frymëzimi i një rryme të tillë vjen nga shumë faktor, ku femra shihet si e lehtë, shfaqjet e saj erotike përcillen me delikatesën e çorapit të mëndafshtë, paraqitja e emocioneve, si dhe reputacionin e keq që ia veshim ne si shoqëri duke e paraqitur. Veshjet e femrave që kanë reformë, janë në promovim të gjendjes së tyre emocionale dhe sociale. Nëpërmjet veshjeve simbolike dhe ekspozimit të trupit, ndihmojnë shoqërinë në përcaktimin e kufijve të saj duke dhënë informacion verbal në lidhje me personin në fjalë.

Nëse loja e femrës me veshjen shihet si objekt për t'u shndërruar pastaj në subjekt me të cilin do merren të tjerët, atëherë përkrahja e nënës natyrë i vjen në ndihmë, duke e arsyetuar me faktin se e bukura nuk përbuzet dhe e zgjedh atë në dhënien e frymës, furtunës, dritës, errësirës, shpresës, dashurisë, dhembshurisë, gëzimit apo trishtimit.

Një pamje tjetër e përdorur për të shtuar më shumë emocion është edhe instalacioni. Paraprakisht një formë që ka pamjen e shturur të femrës, një shkallë mes ekstremeve të shfaqjeve të një gjendjeje me probleme, një ide për të trajtuar dhe shprehur personalitetin e femrës me materialin që e përfaqëson më së miri. Skena të tilla të prodhuara si tapiceri për të përshkruar cilësitë emocionale të femrës, shkalla e abstraksioneve të përdorura me forma të rumbullakëta dhe grisjen e çorapeve, janë realizuar për të shfaqur dhunën, delikatesën, dashurinë dhe pjellshmërinë. Çorapet e mëndafshta, që mund të quhen shpeshherë joshës brenda shijes, njëkohësisht janë edhe të frikshme kur ato grisen. Duke ilustruar ndarjen e materialit në dy faza në origjinën e saj joshëse dhe asaj të frikshme, ku bekimet dhe mallkimet shtrihen bashkë nga abuzimet dhe proceset mashkullore. Përvojat e tmerrshme të femrës janë të përcjella me goditje të cilat kanë forma që ndërtohen nga grisjet që lënë çorapet, gjitha efektet që krijohen kanë fushat sekrete të dhimbjes dhe pasionit. Një skemë e tillë ofron pasqyrimin e imazhit të femrës me detaje të vogla të një fisnikërie dhe fuqie që përcillet me shkëlqimin e materialit, një shkëndijë jetike e imazhit të saj. Materiali që ka

intimitetin e saj, orientimi im është zhvilluar duke theksuar materialin në këmbim me performancën që shkakton materiali duke i kushtuar vëmendje forcës dhe efekteve, që shkaktohen nga grisja e vet materialit.

MODA

Fuqia e modës shikohet si pozicion për të përcaktuar statusin dhe autoritetin, një simbol që ka veshja në historinë e modës. Pika kyçe e politikës, kulturës, artit pamor, biznesit. Në shekullin XVIII moda ishte e lidhur me konceptin e përparimit shoqëror. Që nga mesjeta dekretet e veshjes ishin të ndaluara ku përveç të pasurve mund të aspironin në veshje me një stil kozmopolit, këto ligje u bënë gjithnjë e më shumë të pakuptimta, ku me ardhjen e Revolucionit Francez, tendencat e modës u transformuan në mundësi sociale dhe sollën me vete një stil të ri të veshjes. Moda e shpikur nga elita fillon me dallimet e jashtme dhe ndryshon atëherë kur të tjerët imitojnë atë, braktis një mënyrë për të gjetur një mënyrë të re që gjallëron kërkesat e pasurisë. Moda nuk ekziston në shoqëri pa klasa, ajo i takon shoqërisë që përputhet me interesat dhe nënshtrimin social.

Arti në modë gjithmonë ka pas një rol të veçantë, e sidomos në krijimin e dizajneve ku hasen piktura të kombinuara, skulptura të stampuara ku dizajnerët i shfrytëzuan këto elemente artistike në prezantimin e koleksioneve të veshjeve, p.sh. Yves Saint Laurent prezantoi veshje me elemente gjeometrike të Modrianit, ose Gianni Versaçe ku prezantoi veshje futuriste si dhe Elsa Schiaparelli, kapelë në formë këpuce të krijuar nga Salvador Dali etj. Zëri i artit të modës dëgjohet edhe në teatro të ndryshme të operës, baletit, dramës, filmit, ku kostumet krijohen për personazh të ndryshëm artistik, kjo formë e popullarizuar e kostumeve pa dyshim që është një ndër format më të njohura në fushën e artit të modës. Kombinimi i këtyre dy disiplinave artistike që është futurizmi dhe kontrasti i ngjyrave sollën bashkëpunime ndërmjet artistit dhe kreatorit të modës.

STILI

Stili është një përsëritje e modelimit, qoftë në sjelljen e njeriut ose në objektet e prodhuara nga njerëzit që rezultojnë nga një sërë zgjedhjesh, që bëhen brenda një grupi të kufizuar. Si rregull, disa prej kufizimeve të cilat kufizojnë zgjedhjen janë shpikur rishtazi ose të

shpikura nga ata që punësojnë atë, janë mësuar dhe miratuar si pjesë e rrethanave historiko-kulturore të individëve ose grupeve. Kështu është në muzikë, pikturë dhe artet tjera.³ Stili lind në procesin e punës se si e trajton penelin apo modelin e gjurmëve të mbetura nga objekti. Stili në estetikë ka kuptim më të gjerë, përfaqëson tërësinë e karakteristikave formale të një autori, rregullon organizimin e ideve, planin e veprës, stili është vetë personi.⁴ Ne i njohim karakteristikat e stilit dhe modelet si rëndësi e punës.

Prania e zgjedhjes është e përcaktuar për shkak se nuk janë të njëjta modelet në botë, edhe në atë që mund të konsiderohet aspektet e sjelljes njerëzore. Implikimet e stilit janë nga më të ndryshmet, ajo është fryma e dikujt. Lidhja me një stil është se si të gjitha atributet e tij të përshtaten së bashku dhe të ndërveprojnë me njëri-tjetrin.⁵ Lëvizje e shekullit XIX drejtime të reja, gjuhë e re e komunikimit, vija të cilat flasin për një vizion që do përcaktojë elementet e artit, dizajnit e arkitekturës.

Shumë artistë kapërcyen tematikat tradicionale të artit duke gjetur veten në vrullin e botës moderne. Në rrymën e impresionizmit, postimpresionizmit, ekspresionizmit, ekspresionizmit abstrakt, pop artit, op art. Ndërtimi i gjithë këtyre lëvizjeve STILI solli me vete shumë elemente që deri në këtë kohë nuk ishin parë më parë. Vepra që sfidonin hapësirën, baraspeshën, proporcionin etj. Artistë që gjetën frymëzimin në ëndrra, imagjinata, mister, në botën e makinerisë, fotografisë që fiksonin kënde të pazakontë. Stile të ndryshme, kompozime të ndryshme, efekte dramatike, shpejtësi marramendëse, ngjyra të forta, punë dhe lojë. Në fushën e modës dhe veshjeve u krijuan stile të veshjeve siç janë; Bohemian, Uniformity, Amazons, Couturiere, Star, Patriot, Outsider, Avantgarde etj.

³ Lang, Berel, "The Concept of Style", University of Pennsylvania, Philadelphia, (1979), f.3.

⁴ "Stil, nga latinishtja *stilus* (shufër metali me majë, bizë) nga greqishtja (drushtë, shtyllë). Në kuptimin e mirëfilltë stili është shufra metalike me majë që shërben për të shkruar...(për më shumë shih, "fjalor i estetikës", Çausi, T., f.410.

⁵ Lang, Beral, "The Concept of Style", University of Pennsylvania, Philadelphia, 1979, f.8.

INSTALACIONI

Vepër kjo që nxjerr artin nga galeria dhe vendoset në hapësira të ndryshme që nuk kanë lidhje me tradicionalen. Veprat e instalacionit shpesh e shqetësojnë publikun, e ngacmojnë atë, instalacionet e ndryshme të ndërtura nga artist të artit konceptual bartin me vete fuqi të mëdha emocionale. Termi i *artit konceptual* qëndron aq i rëndësishëm sa vetë puna, forma të veçanta të shprehjes artistike. Lëvizja e një arti avangard që nxiti debate në fund vitet 60', për art dhe që duhet të kualifikohet si art dhe se cili është roli i artistit në këtë rast. Me gjithë këto debate dhe manifestime të deklaratave, doli se në art mbizotëron ideja, në artin konceptual mbi të gjitha është ideja, koncepti dhe materiali. Artistët që punojnë në frymën konceptuale janë të tërhequr nga teoritë filozofike. Arti konceptual sipas kushteve të tij dhe statusit, ka si sfidë konceptet tradicionale të artit dhe estetikës si dhe të filozofisë.

1. Arti konceptual synon për të hequr theksin tradicional në kënaqësi ndijore dhe bukuri, duke e zëvendësuar atë me një theks mbi idetë dhe pikëpamjen se objekt arti është për t'u "dematerializua".

2. Arti konceptual vendos për të sfiduar kufijtë e identitetit dhe përcaktimin e veprave të artit dhe pyetje rolin e agjencisë në art-marrje.

3. Arti konceptual kërkon, shpesh si një reagim ndaj modernizmit, të rishikojë rolin e artit dhe kritikët e saj në mënyrë që art-marrje bëhet një lloj i kritikës së artit, herë pas here edhe promovimin pikëpamjet anti-konsumator dhe anti-themlimit.⁶ Arti konceptual instalacioni sfidon të kuptuarit tanë, jo vetëm estetik, por edhe nëse duhet që arti të jetë gjithmonë estetik.⁷ Ndërmjetësimi i njohurive, ideve, imagjinatës janë të nevojshme në punën e artistit konceptual. Sot në botën e ekonomisë dhe të industrisë së zhvilluar çdo mjet dhe material është i rëndësishëm në shtëpitë tona. Por, çfarë paraqet instalacioni në galeritë bashkëkohore?

Instalacioni është një teknikë sa e re, aq edhe e vjetër. Sa edhe vet arti. Në kohërat e lashta njerëzit punonin dhe kërkonin materialet e përshtatshme për realizimin e punëve, sot po ashtu artisti është në kërkim të një materiali të përshtatshëm për punë, ai sot e kthen materialin veçse në punë.

⁶ Peter, Goldie & Elisabeth Schellekens, "Philosophy And Conceptual Art", Oxford University Press, New York, 2007, f.12

⁷ Po aty, f.15

Gjatë periudhave artistike, shumë artistë filozofinë e tyre e kanë ngritur mbi punën e tyre: kemi artist siç është Jozef Koshut, me filozofinë mbi artin konceptual, ku thotë: *''Të jesh artist sot, domethënë të hulumtosh vetë natyrën e artit... Nëse bëni piktura, atëherë veç e keni pranuar (të mos hulumtoni)''*.⁸ *''Puna është që çdo gjë e arsyeshme, është reale''* (Hegel). Forma e instalacionit varet nga qëndrimi i formës intelektuale të artistit, i cili arrin filozofinë mbi frymën e lirë, që është shpirti dhe trupi. Ky art bashkëkohor jep ndjesinë e fuqisë, të dhimbjes, dashurisë si artet tjera, veçse këtu kemi të bëjmë me materialin si simbol të gjithë kësaj ndjesie. Në këtë rast materiali jemi ne njerëzit e figura qëndron para nesh.

Njohja e intuitave na jep sigurinë, njohja e shqisave jep të përcaktojme etikën e kuptueshme, demonstrimi nëpërmjet artit të instalacionit na lejon të tregojmë sigurinë e shqisave të të pamurit. Nëpërmjet artit të instalacionit arrijmë të eksperimentojmë mbi realen e deri në surrealizëm, ku ëndrrën arrijmë ta kthejmë në realitetin shoqëror.

Arti përsëritet në forma të ndryshme dhe këto forma vijnë nga natyra dhe filozofia jonë për jetën, të shohim të njohurën nepërmjet të çuditshmes. Gjithsesi, arti i instalacionit është krijuar për t'u admiruar dhe për më tepër për ta shijuar të bukurën dhe të çuditshmen. E çuditshme është mënyra e ekspozimit, e bukura është ideja dhe realizimi i këtij arti bashkëkohor.

PERFORMANCA

Arti i performancës, arti i përjetimit dhe sfidimit të skenës. Arti i shfaqjeve të dukurive më të pazakonta, të cilat prezantohen me tematika të njëjta si në pikturë, por me teknikë dhe materiale nga më të ndryshmet. Prezantim i efekteve të lojës së artit, ekzekutim i punës, veprës artistike, e cila ngërthen elemente të shumta të arteve, prezantimi në format më të ndryshe e të çuditshme të artit bashkëkohor. Performanca shpallor punën e muzikologut, skulptorit, aktorit, piktorit, shumëllojshmëria e materialeve e ndihmon artistin në prezantimin e veprës së vet, duke e zhvilluar para publikut. Arti i gjithë arteve. Ky art mori hov në vitet pesëdhjeta me të ashtuquajtur "happenings".

Artist-stilist, krijuan veshje nga materiale të ricikluara siç janë: nga zinxhir-patenta, doreza, xhami, letra, metrazhe të ricikluara etj.

⁸ Dikson, Grejam, Endrju, "Umetnost, Velika Ilustrovana Enciklopedija", Prevod, Jankovic, Vladimir, Mladenska knjiga, Beograd, (2012), f.561

Projektuesi i njohur belg Maison Martin Margiela, ndonëse enigmatik rrallë i intervistuar ai dhe ekipi i tij, në një dyqan sinjalizues në rugicë, krijuan me materiale të dorës së dytë të ricikluara, duke rimodeluar një bust me zinxhir (patenta).⁹

Performanca e Viktor dhe Ralf është një koskallitjen e trupit si tek ato femra të reja adoleshente, të shtatzënisë dhe tek më të moshuarat. I projektuar për të fshehur pjesë të shëndosha të barkut apo për të theksuar belin e hollë, korseti ishte thelbësor, jo vetëm në ndërtimin e feminitetit, por edhe në ndërtimin e një identiteti të klasës së bazuar dhe subjektivitetin.¹⁰ Element i theksuar në veshjet e femrave në epoka të ndryshme të historisë së veshjes e theksuar kështu në renesansë, barok, rokoko periudhën viktoriane, ky element aq i diskutueshëm në shoqëri në debatet e mjekësisë për përshkrimin e përparësive dhe rreziqeve të saj.

Korseti ishte një veshje edhe e meshkujve, ishte një veshje e dukshme me zbukurime, ku shtrëngohej me lidhëse dhe tërhiqej. Në fillim të shekullit XIX, korseti mori një kthesë ku në vend të shfaqjeve të jashtme dhe të bukura, ajo do përdorej vetëm nga ana e femrave dhe me zhdukjen e saj si veshje e jashtme, do zëvendësohej me atë të brendshmen.

Mbretërimi i gjatë i korsetit ka bërë për shumë gra përfitime të sëmundjeve, por njëkohësisht aftësia për të trajnuar një trup të hershëm në gdhendjet ideale. Me mbajtjen e korsetit nga klasa e mesme, feminiteti pasqyronte idealet e modës. Kjo veshje me përparësitë dhe të metat, ishte i rëndësishëm për të zbatuar një sërë qëllime ideologjike.¹¹ Rreth vitit 1850 femrat vishnin fustane të cilat përbëheshin nga korseti i fortë që rrethonin belin me funde të gjatë mbështetur në kafaz-kosh të krijuar nga një dru i hollë.¹² Këto veshje ngjasonin njëra me tjetrën në përditshmëri, çka ndryshonte në të ishte materiali, ai që si një rregull ku në këto veshje duhej të përdorej materiali i çmuar dhe delikat.

Në vitin 1850, një lëvizje e grave feministe por edhe mjekëve, punuan në përpjekje për të braktisur korsetin si veshje jo e lirshme në punë dhe shëndetin e tyre. Reformat e arsimit feminist u angazhuan për të popullarizuar veshjet sportive të lirshme me veshje estetike dhe

⁹ Blackman, C., "100 Years of Fashion", Laurence King Publishing, 2012, f.341

¹⁰ Summers, Leigh, "A History of the Victorian Corset", Berg, Oxford, 2001, f.9.

¹¹ Summers, Leigh, "A History of the Victorian Corset", Berg, Oxford, 2001, f.121

¹² Holscher, J., Beukel, D., "Fashion Design 1800-1940", Pepin Press, Netherlands, 2001, f.8

artistike. Korseti edhe pse shumë reforma, përpjekje, lëvizje kanë punuar për të bindur gruan për dëmet që shkakton korseti, ajo prapëse-prapë vazhdoi në përdorimin e saj deri në vitet 1960, ajo është e pranishme edhe në ditët tona, si veshje ndaj kontrollit dhe mirëmbajtjes së linjave të trupit së femrës. Një veshje që me shekuj e përdorur dhe më një sërë kritikash, me një popullaritet dhe jetëgjatësi që ka korseti, pasqyron edhe jetën seksuale dhe erotike të historisë shoqërore. Qëndrimet ndaj seksualitetit femëror në veçanti. Veshja e brendshme tek gratë e projektuar në gjeste të qarta erotike, ku busti i veshjes duket si korset, për të sugjeruar si mbajtës. Megjithëse i konstruktuar për belin, ai ishte i ngurrhtë, i ngjeshur për trupi ku përgjatë periodave të ndryshme vishej edhe nga fëmijët.

Përbërja e materialit për korsete ishte material streç i ngushtë ku shtrëngohej nga lartë me radhë për teposhtë. Nga vitet 1794 e deri me 1800, korsetet ishin të shkurtra dhe nuk ishin veshur në mënyrë universale.¹³ Korsetat e gjatë u krijuan nga materiali i pëlhurës së fortë dhe mpiksen me bri balene. Korsetet ndërtoheshin edhe nga çeliku dhe kockat e ngurta ku lidhen nga mbrapa. Korsetet e shkurtër ishin në mënyrë të barabartë të ngurrhtë ku nga mbrapa kishin gajtan, si një mënyrë për të treguar ijet e vogla dhe gjoksin e plotë. Nga korsetet e shpikura ne shohim gra me ije të shtypura në një perimetër më të madh nga ai i belit ku gjoksin e ngre shumë lartë, duke krijuar rrathë të neveritshëm mishi për shikuesin, dhe të parehatshme për grup-moshat më të vjetra.

Lidhëset shtrënguese në epoka të ndryshme sa vinin e bëheshin me progresive, më të rënda, pjesërisht për të nxjerrë në pah belin e vogël e të admiruar dhe pjesërisht si një përmbajtje morale korrigjimit të Regjencës. Qëndrimi shtrihet jo vetëm mbi gjirin, por edhe të gjithë zonën e barkut dhe të kthehet deri tek legeni. Modele të reja në frazat e tilla siç është edhe romantika, figura e femrës është e madhërisht me një elegancë të hollë të ngushtuar përgjatë torsit si gjarpër.

Realizimi i ardhshëm i një shtrënguesi të ijeve do vinte pikërisht në vitin 1867 nga Thomson's "Fiks një korset i përshtatshëm", i cili do të mbërthehej nga para, me kopsa druri.¹⁴ Të gjithë korsetet pa marrë parasysh se kanë dantella para ose mbrapa, ato kishin një rol. Nën titullin "*Korseti bën figurën*", shteti në vitin 1912 deklaroi se konturat

¹³ C.Willett, P. Cunnington "The History of Underclothes", Dover, New York, 2015, f.115

¹⁴ C.Willett, P. Cunnington "The History of Underclothes", Dover, New York, 2015, f.179

e figurës japin efektin natyral me linja të gjata dhe ije pak të lakuara por të kufizuara. Forma të ndryshme të korseteve në epoka të ndryshme janë rezultat i kërkesës së madhe mbi figurën e gdhendur të femrës, po në këtë vit korseti merr kthesë të madhe duke u shkurtuar në bel dhe duke u zgjatur poshtë në pjesën e vitheve me material elastik dhe ndihmën e çelikut.¹⁵ Në vitet më pas pasuan edhe linja të reja të korseteve, duke e bërë ndarjen në dy pjesë, kombinimi i korsetit me pjesën e sytjenave (gjimbajtës), jelek, rrip për belin, bodi, korse-pantallona etj. Këto linja të korseteve vazhdojnë edhe sot në tregun tonë.

MBUROJA E FEMRËS

Beteja e dhimbshme e femrës në emër të lirisë, që vazhdon duke na sjellë me vete elementet që e karakterizojnë forcën për mbijetesë, e që ajo di më së miri të kujdeset për këtë, janë padyshim veshjet që futen në shërbim të forcës. Duke zhvendosur gjithë dashurinë në mbrojtje për frytin e saj, ajo mbetet besnike e veshjeve. Ndërhyrja dhe transformimi në forcat tërheqëse zhvillohet me vetëdije. Ky guxim që çdo femër do e merrte përsipër të ndryshonte mendimet për femrën në të mirë, ku do thoshte edhe filozofi i njohur gjerman Immanuel Kant, “*MIRË ËSHTË*”.

Veshja e femrës nuk duhet të shikohet si element ngacmues, nuk është veshja ajo që na ngacmon, ndonëse shpesh e shohim të tillë, janë format që natyra ia dha femrës për të ngjallë dashuri. Tek kafshët e ndryshme nuk është lëkura apo puplat e bukura vetëm tek femra, por i posedon mashkulli që tërheq vëmendjen e tyre, e që në këtë rast nuk është surogat (zëvendësues) e mençurisë dhe dijes. Dija zhvillohet me zhvillimin e saj edhe ne fusim veshjen në shërbim të këtyre dijeve, duke e përdorur si armë, mburojë. Dhe mu atëherë kur thuhet që është mirë pse vazhdojmë të zëvendësojmë gruan me një vajzë që ka makijazh, dhe posedon një armë më të fortë se një bashkëshorte, grua, nënë apo vazhdojnë të na pëlqejnë format natyrale.

Në rrugëtimin e zhvillimit të njeriut gjithmonë kemi shfaqur interes për trupin apo format, si dhe kemi ndikuar duke garantuar në plotësimin e nevojave të tyre. Nëse për mashkullin veshja është element për të garantuar ngrohtësi dhe performancë estetike, tek femra veshja ka qenë mburojë në çdo pjesë të paraqitjes së sajë, dhe si e tillë ka

¹⁵ Po aty, f.227

përcjellë elemente hyjnore. Elementet hyjnore tek femra janë të thella, ato depërtojnë nga imazhet e hapësirës deri tek figurat të rrethuara me florën dhe faunën që mposhtin çdo trishtim, duke ngjallë admirim në petkun e saj që shtrihet përgjatë trupit, ku kjo e forcon natyrën e saj të brishtë.

Korseti i projektuar për mbështetje të trupit, paraqitur me material të cilat në vete përcjellin mesazh, lidhshmëria e gozhdëve dhe perit, e që në tapiceri flet vet materia që ka lidhjen e forcës dhe mbrojtjes. Meqë roli i gozhdës shihet si element ndërtimi dhe ka forcën e qëndrueshmërisë, ajo tek tapiceria ka rol po me karakterin e forcës mbrojtëse. Një bust i shtrënguar me material si nga metali, lëkura, druri, peri etj., i krijuar për linjën e trupit të femrës e që shekuj me radhë e karakterizon trupin e hollë e elegant të linjave natyrore të femrës.¹⁶ Plotësimi i materialit me theksimin e konturave të një teknike më ndryshe e që ka efikasitetin dhe lëvizjen bashkohen në vete, duke na bërë më kuriozë në thellimin e njohjes së këtyre dy përbërësve. Eksplorimi i materialit me potencialin e gruas janë dy fusha që lidhen njëra me tjetrën, duke treguar dukshëm ndikimin e forcës dhe instinktut. Ndërlidhja e dizajnit në veshje-fustane i jep frymë përshkrimeve, duke e ngritur atë në konceptin që bart interpretimin, komentimin, zhvendosjen e kuptimit të veshjes në kushtet shoqërore, rolin kompleks që ka veshja, pikat më të shquara të saja. Pikëpamjet filozofike janë komentuar apo justifikuar që femrat gjithmonë bërtasin.¹⁷

Raportet midis meshkujve dhe femrave janë të karakterizuara me aftësinë e tyre për nga lloji dhe aftësitë për zgjedhje. Ideali që varej në mënyrë të hapur me edukimin e grave nga fëmijëria për urtësi që duhej nënshtruar dhe që pozitivisht duhet të organizohej jeta e tyre rreth nevojave të burrit dhe fëmijëve. Pasi kjo është e përcaktuar për to nga filozofët, edukatorët, shkrimtarë si dhe artistë të periudhës, duke e

¹⁶ The Columbia Encyclopedia, 6th ed. Copyright 2016, The Columbia University Press.

¹⁷ Cit. Ruso, në përgjithësi ka pranuar pikëpamjen për femrën, por tërësisht ka justifikuar këtë perspektive pas kritikave dhe është përpjekur për ndryshime. "femrat për herë bërtasin, sepse ne i kemi edukuar ato për asgjë, për kotësitë dhe nazet e tyre, për atë ne imbamjë ato për zbavitje dhe shaka, në mënyrë që ne të jemi zotëruar, sepse sipas tyre ne jemi përgjegjës - thonë ato, ndërkaq të metat ne ua atribuojmë atyre. Çfarë marrëzie!", është shprehur Rusoi, në interpretimin e tij për femrën. "MBI EDUKATEN"(1762).

pranuar "Natyren e Tyre"¹⁸. Ndërsa filozofja franceze Simone De Beauvoir thekson se "Femër nuk lind, por bëhesh".¹⁹

Në këtë rast, flet materiali i përzgjedhur i cili ka aftësinë e forcës dhe mendjes që femra di të modelojë me delikatesë konturet ideale të saj dhe na mbërthen në boshtin e ngrohtë. Joshjet e mundshme të femrës, synimi dhe pikëpamjet e ndryshme të gjendjes së saj në shoqërinë që e rrethon, e që vazhdimisht theksohet me veshjen, duke futur arsyen përpara realitetit. Frymëzimi i një rryme të tillë vjen nga shumë faktorë, ku femra shihet si e lehtë, shfaqjet e saj erotike përcillen me delikatesën e çorapit të mëndafshhtë, paraqitja e emocioneve, si dhe reputacionin e keq që ia veshim ne si shoqëri duke e paragjykuar. Vlerat e moralit duhet të ndërtohen mbi bazën e natyrës së vërtetë të njeriut dhe mjedisit të tij.²⁰

Kërkesa për të bukurën ideale, roli i gruas në shoqëri kapet si motiv i një veshje me përplot hiri me shfaqjen erotike, me motive të një mendjelehte dhe një paraqitje të një mëkatare. Zinxhir idesh për karakterin e femrës rrethojnë mendime për femrën e shekullit XXI. Jehona e këtyre ideve është e pranishme në çdo faqe të shoqërisë. Edhe paragjykimi i femrës në konceptin e shijes artistike, në disa raste mund ta tolerojmë, pasi vullneti i ideve dhe imagjinatës na lejon të paragjykojmë shijen e të bukurës të një femre, gjë për mashkullin si gjini që joshet pas shijes së hollë femërore. Andaj, paragjykimi i femrës në shijen e të bukurës mund edhe të kuptohet si paraqitje artistike në mesin e natyrës ku vepron. Paraqitja e një koncepti të këtillë krijohet me fragment të formës që shërben në hartimin e lirë duke respektuar ligjet e natyrës. Andaj, kemi femrën me armën e saj për pushtet, ndaj shoqërisë e cila bashkë me materien i përgjigjet shoqërisë me mënyrën

¹⁸ Mary D.Garrard, "Feminism and Art History", Icon Editions, Boulder CO, 1982, f.9

¹⁹ Cit. Simone De Beauvoir, shoqja e shkrimtarit të njohur Jean-Paul Sartre, ishte ajo që rikonceptoi edhe një herë letërsinë feministe duke u thelluar edhe më shumë në kërkimin e moralit të së vërtetës, që i shpall luftë të hapur konformizmit. Postulati i saj i famshëm "Femër nuk lind, por bëhesh" i mëshon qartë fatit të vulosur të gruas, që lind si e tillë dhe bëhet femër; një qenie e mangët dhe thelbësisht e ndryshme nga burri, pra as më pak e as më shumë së "një seks i dytë", sekondar. Vepra e saj "Seksi i Dytë", është kthyer gjithashtu në një manifest të vërtetë feminist që analizon në mënyrë kirurgjikale 'gjendjen e gruas' në kohë të ndryshme, përgjatë gjithë zhvillimeve historike.

²⁰ Stumpf, "Filozofia", Niçe, Rivlersimi i të gjitha moraleve, f.364.

intime ndaj të vërtetës së pashmangshme, drejtë bindjeve për dashurinë dhe të bukurën. Mbijetesa e femrës shfaqet me emocionin, kalimi i një emocionin në një tjetër ku zakonisht e hasim si emocion i frikës dhe dëshirës.

Veshjet e femrave që kanë reformë, janë në promovim të gjendjes së tyre emocionale dhe sociale. Nëpërmjet veshjeve simbolike dhe ekspozimit të trupit, ndihmojnë shoqërinë në përcaktimin e kufijve të saj duke dhënë informacion verbal në lidhje me personin në fjalë. Veshjet unike që karakterizohen nga grupe të veçanta mund të sjellin izolim të anëtarëve të grupit.²¹ Në fillim shohim piktura të paraqitura që të tërheqin vëmendjen për nga ndërtimi i tyre në fushën figurative, të cilat me anën e ngjyrave dhe ekspresivitetit që kanë lidhjen e natyrës së femrës me nënën natyrë.

Lidhshmëria e këtyre dy elementeve janë të përafërta njëra me tjetrën, ato kanë ngritjet dhe humbjet bashkë. Tërmetet natyrore bashkë me lëkundjet e një femre janë të një natyre, bukuritë e natyrës barten tek femra me koloritin e stinëve të vitit. Femra është si stinët ajo është e gjallë, e ngrohtë, e brishtë, e ftohtë. Figurat e modeleve të paraqitura me anën e pikturës janë natyra të frymëzuara për nga karakteri i nënës natyrë, që na dhuron neve për një pamje të përafërt më të, që trupi dhe natyra bëhen një dhe japin fuqinë e shpërthimit të karaktereve. Fuqitë natyrore japin spektakël nga më të ndryshme duke na bërë të ndihemi të habitur dhe të shtangur. Këto fuqi të bukura femra i bart me veshjen, duke na sjellë emocione për nga karakteri dhe roli i saj në shoqëri. Veshja e femrës është simbol i bukurisë, simbol i dhimbjes e vuajtjes, simbol i dashurisë, simbol i mbrojtjes dhe hakmarrjes. Lidhjet që i bëhen natyrës së femrës me nënën natyrë janë të njëjta, ato janë riprodhuese, rilindin, dashurojnë, kanë dhembshurinë si dhe hakmarrjen. Ato plotësojnë njëra-tjetrën, nëna natyrë jep imazhin, ndërsa fryma dhe shpirti është tek vetë femra.

Sipas Pitagorës, i cili thotë që një parim i mirë është që u krijua rregulli, drita dhe burri, dhe një parim të keq që ka krijuar kaosin errësirën dhe gruan. Atëherë errësira dhe kaosi vijnë nga verbimi i dritës së madhe. Ndërsa, Kanti në veprën e tij “Mbi të bukurën dhe të madhërishtmen”, shkruan se “Janë të pastra dhe të ndjeshme ndaj çdo gjëje të neveritshme”. Ndjeshmëria është afër emocionit të neveritshmes.

²¹ Douglas, M, “Natural Symbols”, New York, Pantheon Books, (1996), f.54

Pasqyrimi i Kantit për femrën ishte se i duhet një disiplinim, ku duhet të edukohet patjetër në gjërat praktike.²² Nëse loja e femrës me veshjen shihet si objekt për t'u shndërruar pastaj në subjekt me të cilën do merren të tjerët, atëherë përkrahja e nënës natyrë i vjen në ndihmë duke e arsyetuar me faktin se e bukura nuk përbuzet dhe e zgjedh atë në dhënien e frymës, furtunës, dritës, errësirës, shpresës, dashurisë, dhe mbshurisë, gëzimit apo trishtimit. Përcjellja e gjitha këtyre elementeve shprehet me lëvizjen e penelit mbi fusha të ngjeshura me ngjyrë e në të cilat sigurojnë një lidhje mes tingujve të natyrës së femrës dhe botës që e rrethon, mënyra në të cilën përcillen të gjitha së bashku, trupi, mendja e plotësojnë imazhin e "çuditshëm" të femrës. Veshja shkaktohet vizualisht edhe psikologjikisht ku bien në sy format, vala e ngjyrave të panumërta dhe shkëlqimi që ka tendencën për të dhënë urdhër dhe mbrojtje, kontribuon në prodhimin e efekteve dramatike duke krijuar intensitet dominues emocional. Veshjet-fustanet apo edhe metrazhet nga karakteri kanë linjën e caktuar, dritën, hijen, tonet e zymta që përcillen në tablotë për të prodhuar efekte psikologjike dhe estetike. Një lojë e tillë e linjave, ngjyrave të ngrohta dhe të ftohta që sugjerojnë një lojë misteri të gruas-femrës. Tonaliteti i ngjyrave është tek femra, ajo bartë ngjyrat e jetës, shpresës, pastërtisë, dashurisë, ato qëndrojnë bukur në veshjet e saj duke e stolisur, dhe duke i dhënë forcë, kërcënimi vjen nga dyshimi i botës së egër mbi vlerat e fuqisë së ndërtimit të veshjes.

Një pamje tjetër e përdorur për të shtuar më shumë emocion është edhe instalacioni. Paraprakisht një formë që ka pamjen e shthurur të femrës, një shkallë mes ekstremeve të shfaqjeve të një gjendjeje me probleme, një ide për të trajtuar dhe shprehur personalitetin e femrës me materialin që e përfaqëson më së miri. Skena të tilla të prodhuara si tapiceri për të përshkruar cilësitë emocionale të femrës, shkalla e

²² Kanti si shumë filozofë të tjerë, ishte i vetëdijshëm se balanca shoqërore nuk do të arrihej në momentin kur nuk do të ekzistonte stratifikimi gjinor. Pozita nënshtruese e femrës do ta mundësonte ruajtjen e familjes dhe shoqërisë në përgjithësi. Në këtë kontekst, Kanti këtë e arriti nëpërmjet ligjit moral dhe atij atyror. Ligji moral këtë filozofi ia mundësoi që jobarazinë ta shohë si forcë shoqërore, ndërkaq ai natyror i ndihmon që nëpërmjet pamjes fizike ajo pa dyshim të pozicionohet në pjesën dytësore. Përderisa, gruaja është një objekt, kuptohet që mënyra më të cilën stoliset dhe vishet e rregullon vlerën e saj qenësore. Derisa femra do të konsiderohet si një objekt, atributi i së bukurës do të jetë pjesë qenësore e subjektit të saj. (lexo, Fundamental Principles of the Metaphysic of Morals. Thomas K. Abbott. 1949. Me një hyrje nga MARVIN FOX Filozof Ohio State University)

abstraksioneve të përdorura me forma të rrumbullakëta dhe grisjen e çorapeve janë realizuar për të shfaqur dhunën, delikatesën, dashurinë dhe pjellshmërinë. Çorapet e mëndafshta që mund të quhen joshës njëkohësisht janë edhe të frikshme kur ato grisen. Duke ilustruar ndarjen e materialit në dy faza në origjinën e saj joshëse dhe asaj të frikshme, ku bekimet dhe mallkimet shtrihen bashkë nga abuzimet dhe proceset mashkullore. Çorapet e mëndafshta shpesh paraqesin joshje ndaj gjinisë mashkullore, mirëpo edhe në rastin e grisjeve të tyre shpesh japin efektin e kundërt të joshjes, duke e fiksuar idenë gjinia mashkullore, se çorapet e grisura të një femre janë produkt i mosrregullimit dhe përkushtimit të dukjes së saj, dhe kjo është shenja që krijon efekt të kundërt të emocioni dhe vlerësimi i gjinisë mashkullore.

Përvojat e tmerrshme të femrës janë të përcjella me goditje të cilat kanë forma që ndërtohen nga grisjet që lënë çorapet, gjitha efektet që krijohen kanë fushat sekrete të dhimbjes dhe pasionit. Një skemë e tillë ofron pasqyrimin e imazhit të femrës me detaje të vogla të një fisnikërie dhe fuqie që përcillet me shkëlqimin e materialit, një shkëndijë jetike e imazhit të saj. Materiali që ka intimitetin e saj, orientimi im është zhvilluar duke theksuar materialin në këmbim me performancën që shkakton materiali, duke i kushtuar vëmendje forcës dhe efekteve, që shkaktohen nga grisja e vet materialit.

Në saje të teknikës që është përdorur zbulohen mënyrat më intime e një familjeje ku kornizat përmbledhin këndin shtëpi, familje, burrë, d.m.th. muret e shtëpisë, duke përcjell raportet mes burrit dhe gruas si dhe ndjeshmëria e cila përcillet me elemente të detajuara. Konflikti ekziston në një formë veçanërisht e ndërlikuar mes burrave dhe grave, sepse qeniet njerëzore janë speciet më bashkëpunuese në tokë.²³ Andaj edhe lidhjet e tyre janë të komplikuar ku vërehet lidhja e materialit me forma dhe ngjyra që bashkëpunojnë njëra me tjetrën në tentativë për të rënë dakord me përgjegjshmëritë që bartin si familje, ndonëse këto përgjegjësi shpesh janë komplekse dhe të ndërlikuara, duke shfaqur dhunë. Dhuna në këto instalacione shfaqet me grisjen e çorapeve, sepse rrjedha e dhunës në shoqërinë tonë është rritur në mënyrë drastike. Faktorët social, të ardhurat, janë arsyt kryesore që ndikojnë fuqishëm në sjellje. Kjo është një dukuri dinamike dhe komplekse që cenon natyrën e organizimit të njeriut.²⁴ Kur flasim për gjininë gjithashtu

²³ Seabright, P, ‘‘The War of the Sexes’’, University Press, Princeton, NJ, 2012, f.6.

²⁴ Dhuna në familje është një çështje sociale që përfshihen në të gjithë jetesën e njeriut atë, socio-ekonomike, racore, kufijtë etnike, gjinisë dhe moshës.

flasim për hierarkinë, pushtetin dhe pabarazinë. Fuqia simbolike e femrës-veshja e vellos, bashkëpunon mes marrëdhënieve ndërmjet mashkullit duke shfaqur dashurinë, fuqia e padukshme përmbledhet me lidhjen e kornizave mes pastërtisë dhe pasionit, ku në fushat tjera të instalacioneve kemi paraqitur fusha me ngjyrë dhe lidhje të materialit për të treguar pasionin dhe seksualitetin mes burrit dhe gruas.



Abuzimi dhe neglizhenca mund të gjenden në të gjitha llojet e familjeve dhe marrëdhëniet ndërpersonale, duke kapërcyer jetëgjatësinë. Kjo është një dukuri dinamike dhe komplekse që cenon natyrën e organizimit të njeriut. Struktura e familjes ekziston në të gjitha kulturat, me detyrën kryesore të mbarështimit dhe të kujdesen për të dy të rinj dhe të vjetër njësoj. Edhe jashtë shtëpisë mjedise të kujdesit, të tilla si shtëpi pleqsh ose objekteve të trajtimit të banimit, në të cilën familjet pseudo janë formuar në përgjithësi janë duke luftuar për të përmirësuar cilësinë e jetës për banorët. Abuzimi dhe neglizhimi brenda kontekstit të familjes paraqet një shkelje të funksionit të shenjtë dhe qëllimin. Prandaj, keqtrajtimi familje ka pasoja shkatërruese. Pasojat përfshijnë shëndetin fizik, mendor, si dhe të sjelljes, arritje akademike, sukses ekonomik, dhe jetëgjatësi. Në një minimum, dhuna në shtëpi pengon cilësinë e jetës për anëtarët e familjes dhe, në raste ekstreme, mund të rezultojë në vdekje. (lexo, Violenc in the Home, Petcosky, L., Jacqueline, Oxford University Press, New York, 2003)



Summary

The painful struggle of women in the name of freedom that continues to bring with us the elements that characterizes the survival force, which she knows best to take care of is undoubtedly the outfits that they put into the service of force.

On the way of human development we have always shown interest in body or shape and we have affect by guaranteeing to know their needs. If for men the coating is an element to guarantee warmth and aesthetic performance, women dress has been boasting in every part of her appearance and as such has followed divine elements. In this case speaks the selected material which has the power of mind that the woman knows to delineate delicately its ideal contours and grips us to the warm axis. Possible female seductions, intentions and different views of her situation in the society that's surrounds are constantly emphasized in the dress, introducing reason before reality.

The inspiration of such a flow comes from many factors, where women are seen as easy, her erotic performances are accompanied by the delicate silk stockings, the appearance of emotions and the bad reputation we give them with a society prejudging. The wardrobe of women who have reform is in the promotion of their emotional and social status. Through symbolic clothing and body exposure, helping society determine her boundaries by providing verbal information about the person in question. If the woman's game with the garment is seen as an object to be transformed then in a subject with which others will be taken, then the support of the mother of nature comes to the aid by reasoning with the fact that the beautiful does not despise and chooses it in giving the breath, storm, light, darkness, hope, love, compassion, joy, sadness.

Another view used to add more emotion is the installation in advance, a form that has the wisdom of a woman, a level between the extremes of the emergence of a troubled form, an idea to treat and express the female's personality with the material that best represents her. Such scenes produced as tapioche to describe the emotional qualities of a woman the degree of abstractions used in round form and socks shredding have been realized to show violence, delicacy, love and fertility. Silk socks that can be called enticing are also scary when they are torn. Illustrating the two-stage material divide in its glamorous and frightening origin, where blessings and curses lie together from abuses and masculine processes.

The terrible experiences of women are accompanied by blows that have shapes that are built by dusting that leaves the socks, all the effects that are created have the secret areas of pain and passion. Such a scheme provides the image of a woman with small details of a nobility and power that is accompanied by the splendor of the material, a vital sound of her image.

The material that has its intimacy, my orientation, has been developed by emphasizing the material in exchange for the performance that causes the material, paying attention to the strength and effects that are caused by the material's tearing.

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

- BLACKMAN,Cally,"*100 Years of Fashion*", Laurence King Publishing, 2012
- BOUCHER,François, "*20.000 Years of Fashion, The History Of Costume and Personal Adornmet*", ABRAMS, INC, New York
- WILLETT, C., Phillis,Cunnington. "*The History of Underclothes*", Dover, New York, 2015
- CASHEL Hoey, John Lille, "*History of Fashion in France*", The University of Georgia, Scribner and Wilford, New York, 1882
- ÇAUSHI, Tefik, "*Fjalori estetik*", Ombra, Tirana, 2005
- DIKSON, Grejam, Endrju, "*Umetnost, Velikallustrovana, Encikopedija*", Prevod, Jankovic, Vladimir, Mladenska knjiga, Beograd, 2012
- DOUGLAS, M, "*Natural Symbol*", New York, Pantheon Books, 1996.
- FOCH,Ivan, "*Uvod u Estetike*", Svjetlost, Sarajevo, 1980
- GERLIQ, Danko, "*Estetika-historia e problemeve filozofike*", Rilindja, Prishtinë, 1984
- GOMBRICH, H., E., "*The Story Of Art*", Soros,Tiranë, 1996
- GUXHOLLI,Eduard, '*Mjeshër të Pikturës*', 8 Nëntori,Tiranë, 1990
- HANFLING,Osvald, '*Estetika Filozofike*',Camaj-Pipa, Shkodër, 1999.
- HOLSCHER, J. Beukel, D, '*Fashion Design 1800-1940*', Pepin Press, Netherlands,2001
- KANT, Immanuel, '*Kritika e Gjykimit*' Plejad, Tiranë, 2004
- LANG,Berel,"*The Concept of Style*", University of Pennsylvania, Philadelphia, 1979
- LEVENTON, M., "*What People Wore When*", Griffin, New York, 2008.
- MARY D.Garrard, "*Feminism and Art History*", Icon Editions, Boulder CO, 1982
- MUZETË e botës, "Muze i Vatikanit",përkthyer në shqip nga Ali Rexha, Rilindja, Prishtinë, 1980
- PETCOSKY, L, Jacqueline, Oxford University Press, New York, 2003
- PETER,Goldie & Elisabeth Schellekens, '*Philosophy And Conceptual Art*',Oxford University Press, New York, 2007
- SEABRIGHT,P, "*The War of the Sexes*", University Press, Princeton, NJ, 2012

STUMPF, Enoch, Samuel, *"Filozofia"*, Prevrednovanje svih vrjednosti, Toena, Tirana

SUMMERS, Leigh, *"A History of the Victorian Corset"*, Berg, Oxford, 2001

TAINÉ, A. H., *"Filozofia e Artit"*, Ideart, Tiranë, 2004

"THE COLUMBIA Encyclopedia, 6th" ed. Copyright 2016, The Columbia University Press.

THE COLLECTION of the Kyoto Costume Institute, *"Fashion", A History from the 18th to 20th Century"*, Taschen, Bibliotheca Universalis, 1995

THOMAS K. ABBOTT. *Uz uvod filozof FOX MARVIN* Ohio State University 1949.